



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701039/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandojmë marrjen e masave organizative për shpejtimin dhe përfundimin e gjykimit të çështjes administrative datë 22.01.2016, me ankues shtetasin R.D. nga Dibra.

Drejtuar : Z. KASTRIOT SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijeni : Z.Ramiz DAUTI
Shoqata e P.A.K. Dibër

PESHKOPI

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 14.08.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi R.D. nga Dibra, na shkruan se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë Tiranë, me vendimin e saj me Nr.503 datë 22.09.2015 ka vendosur:

Prishjen e vendimit me Nr.101 datë 19.01.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila nga data 22.01.2016 e deri sot ana e saj nuk ka marrë masat organizative për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar nga kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH dhe nenit 6/1 i KEDNJ.

Po kështu, ankuesi R. D. nga ana e tij, na shkruan gjithashtu se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në rastin konkret duhet të zbatojë dhe të respektojë kërkesat e nenit 48/2 të Ligjit me Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreveshjeve administrative, ku përcaktohet se:

"Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes nga Gjykata ku është paraqitur ankimi".

Duke studjuar me kujdes ankesën e shtetasit R. D., rezulton se ai ka kundërshtuar vendimin nr.160 dt.16.09.2010 të Komisionit Njësisë Policisë Rrugore Dibër, për të cilin ai ka gjykuar t'i drejtohet me ankim Gjykatës Rrethit Gjyqësor Dibër e cila me vendimin e saj nr.121 datë 07.03.2011 ka vendosur Rrëzimin e kërkesës.

Ndaj këtij vendimi ankuesi është ankuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj Nr.101 datë 19.01.2012 ka vendosur : Mospranimin e ankimit.

Ndaj këtyre dy vendimeve ankuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, e cila me vendimin e saj me Nr.503 datë 22.09.2015 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë e cila e ka regjistruar për gjykim me Nr.Regj.31023-oo332-86-2016 datë 22.01.2016, dhe pas hedhjes së shortit elektronik ka caktuar si Relator Z.Bari SHUTI, i cili nga ana e tij akoma nuk ka planifikuar dhe caktuar gjykimin e saj.

Duke analizuar kushtet dhe rrethanat e kësaj çështje gjyqësore, dhe faktin se nga fillimi i këtij gjykimi deri sot kanë kaluar rreth 7 vjet nga të gjitha shkallët e gjykimit dhe faktin tjetër se kërkesa e tij ka rezultuar e drejtë, mendojmë se në rastin konkret ky rast duhet trajtuar nga ana juaj ***si rast i veçantë dhe të shikohen mundësitë ligjore të shpejtimit të këtij gjykimi.***

Ashtu siç parashikohet nga neni 2 i Ligjit me Nr.49/2012 ku ndër parimet e gjykimit administrative ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrveshjeve administrative, dhe se qëllimi i krijimit të gjykatave administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjekteve dhe interesave të ligjshme të personave, nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/4 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se:

”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të Njeriut, nga administrata publike”, dhe në respekt të kërkesave të neni 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit” ku thuhet shprehimisht, se:

”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”, ju

REKONANDOJMË :

1.Marrjen e masave tekniko - organizative për planifikimin dhe përfundimin sa më shpejtë, të gjykimit të çështjes administrative të regjistruar në atë Gjykatë, me datë 22.01.2016 me ankues R.D. nga Dibra.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj dhe për pranimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim, brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI